



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me nenin 63 dhe nenin 64.2 nën paragrafi 2.1 dhe nenin 66 paragrafi 2 i Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 06.06.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rregullores së Brendshme (KQZ) Nr.12/2024 për Përdorimin e Telefonisë Fikse dhe Mobile

- I. Miratohet Rregullorja e Brendshme (KQZ) Nr.12/2024 për Përdorimin e Telefonisë Fikse dhe Mobile.
- II. Rregullorja, si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 06.06.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64.2 nën paragrafi 2.1 dhe nenin 66 paragrafi 2 i Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 06.06.2024, miraton këtë:

RREGULLORE E BRENDSHME (KQZ) NR. 12/2024
PËR PËRDORIMIN E TELEFONISË FIKSE DHE MOBILE

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat e përdorimit dhe shumat e lejuara të shpenzimeve për telefoni fikse dhe mobile në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë të punësuarit në KQZ.

Neni 3
Përkufizimet

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e përcaktuar me LZP.

Neni 4
E drejta për shfrytëzim të linjës fikse

1. Të drejtën për qasje në shërbimin e telefonisë fikse e kanë, anëtarët e KQZ-së dhe i gjithë stafi i KQZ-së.
2. Shpenzimet e lejuara mujore dhe niveli i qasjes për shërbimin e telefonisë fikse, janë të përcaktuara në Shtojcën 1, të kësaj Rregulloreje.

3. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni në periudhë zgjedhore apo aktivitete të veçanta mund lejohet ndryshimi i qasjes apo/edhe rritja e lartësisë pas miratimit nga Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së.
4. Në rastet kur aplikohet tarifa e mirëmbajtjes për linjë të telefonisë fikse, atëherë tarifa e mirëmbajtjes nuk përfshihet në lartësinë e shpenzimit të lejuar.

Neni 5

E drejta për mbushje të telefonisë mobile

1. Të drejtën për t'u pajisur me mbushje të telefonisë mobile e kanë anëtarët e KQZ-së dhe i gjithë stafi i SKQZ-së.
2. Shuma mujore e mbushje të telefonisë mobile janë të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.
3. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në periudhë zgjedhore apo aktivitete të veçanta mund lejohet rritja e lartësisë së mbushjeve pas miratimit nga KQZ.
4. KQZ mund të aprovojë mbushje të telefonisë mobile për personelin e angazhuar me kohë të caktuar gjatë procesit zgjedhor, si dhe çdo kategori tjetër të angazhuar në KQZ, sipas planifikimeve buxhetore.

Neni 6

Përgjegjësia për shfrytëzimin e shërbimit të telefonisë

Të gjithë shfrytëzuesit në KQZ, në komunikimet telefonike brenda KQZ-së dhe me institucionet tjera në Kosovë, janë të obliguar të përdorin telefoninë fikse apo mobile ku tarifat e komunikimit janë falas apo më të lira.

Neni 7

Marrja e shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile

1. KQZ kontraktin shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile sipas akteve ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik në Kosovë.
2. Në rastet kur Qeveria e Kosovës apo një institucion tjetër në emër të Qeverisë kontraktin shërbimet me operatorë publik, atëherë KQZ shfrytëzon kontratën e Qeverisë për marrjen e shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile.

3. Në rast të shfrytëzimit të kontratës sipas paragrafit 2 të këtij neni, KQZ mund të nënshkruaj marrëveshje shtesë të detajuar për realizimin e shërbimeve pa negociuar kushtet e përgjithshme të kontratës bazë.

Neni 8

Mbikëqyrja dhe raportimi i shpenzimeve

Divizioni për Buxhet dhe Financa, mbikëqyrë shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile për çdo muaj, dhe raporton tejkalinin eventual të tyre, të përcaktuara me këtë Rregullore të Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së, me se largu deri me datën 15, të muajit vijues.

Neni 9

Tejkalimi i shpenzimeve të telefonisë fikse

1. Të gjitha shpenzimet që e tejkalojnë shumën e përcaktuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje dhe që nuk e kanë miratimin e Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së, mbulohen nga zyrtari, i cili e ka tejkaluar shumën e përcaktuar.
2. Sekretariati kujdeset që në rast të tejkalimit të shumës së lejuar, shuma e tejkaluar t'i ndalohet nga paga.

Neni 10

Planifikimi i shpenzimeve të telefonit

Shpenzimet e telefonisë, duhet të planifikohen në buxhetin vjetor të KQZ-së.

Neni 11

Akumulimi i shpenzimeve

Shuma e shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile nuk mund të barten në muajin vijues.

Neni 12

Instalimi dhe mirëmbajtja e linjave fikse

1. Divizioni i Teknologjisë Informativë Zgjedhore është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të telefonisë fikse.
2. Instalimi i linjës së re, ndryshimi i qasjes apo deaktivizimi i linjës, bëhet duke plotësuar formularin për linjë telefonike, të cilën më pas duhet miratuar mbikëqyrësi i zyrtarit dhe

Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së.

3. Në rast të paraqitjes së problemit të mosfunksionimit të telefonisë fikse, zyrtari përkatës duhet të njoftojë Divizionin për Teknologjisë Informative Zgjedhore.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 Për Shfrytëzimin e Telefonisë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i datës 21.12.2015.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore është shtojca:

Shtojca 1 - Lartësia e lejuar e shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Shtojca 1 - Lartësia e lejuar e shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile.

Nr. rendor	Pozita	Nr. i pozitave	Shuma e lejuar për telefoni mobile	Shuma e lejuar për telefoni fikse
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve				
1	Kryesues i KQZ	1	45	75
2	Anëtar i KQZ	10	45	50
Kabineti i KQZ				
3	Këshilltar Juridik	1	10	5
4	Zëdhënësi	1	20	15
5	Auditor i Brendshëm	2	15	10
6	Asistent Ekzekutiv	2	10	15
7	Vozitës	1	10	5
Sekretariati i KQZ-së				
8	Drejtori i Sekretariatit të KQZ	1	40	50
9	Asistenti Ekzekutiv	1	10	15
10	Zyrtari i Lartë i Prokurimit	1	10	10
11	Zyrtar Certifikues	1	10	5
12	Këshilltar i Lartë Juridik	1	10	5
13	Këshilltar Juridik	1	10	5
14	Drejtor i Departamentit për Operacione Zgjedhore, edukim, informim, analiza dhe trajnime	1	30	20
15	Zyrtar Ekzekutiv i KKZ	38	10	7
16	Udhëheqësi i Divizionit për mbështetje të Operacioneve zgjedhore dhe koordinim në teren	1	30	15
17	Zyrtar për Koordinim ne Teren	1	10	5
18	Zyrtar për Operacione Zgjedhore	1	10	5
19	Zyrtar i logjistikës dhe infrastrukturës zgjedhore	1	10	5
20	Udhëheqësi i Divizionit për Trajnim dhe Analiza Zgjedhore	1	15	15
21	Zyrtar i Lartë i Trajnim	1	10	5
22	Zyrtar i lartë për planifikim dhe hulumtime zgjedhore	1	10	5
23	Udhëheqësi i Divizionit për Edukim dhe Informim	1	15	15
24	Zyrtar i lartë për Edukim dhe Informim të Votuesve	1	10	5
25	Zyrtar i lartë i Informimit me Publikun	1	10	5
26	Drejtori i Departamentit të Teknologjisë Informative Zgjedhore dhe Shërbim të Votuesve	1	30	20
27	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative Zgjedhore	1	15	15
28	Administrator për Sisteme dhe Siguri	1	10	5
29	Administrator për Rrjet dhe Përkrahje të TI	1	10	5
30	Administrator për Ueb Aplikacione dhe Dizajn	1	10	5

31	Administrator për Bazat e të Dhënave dhe Aplikacione zgjedhore	1	10	5
32	Specialist për Teknologji Zgjedhore	1	10	5
33	Udhëheqësi i Divizionit për shërbim te votuesve	1	15	15
34	Zyrtar i lartë i shërbimit për votues	1	10	5
35	Zyrtar i shërbimit për votues	1	10	5
36	Drejtori për financa dhe shërbime të përgjithshme	1	30	20
37	Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa	1	15	15
38	Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa	2	10	5
39	Udhëheqësi i Divizionit për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta	1	15	15
40	Zyrtar i Lartë për Përkthim	3	10	5
41	Zyrtar i Transportit	2	10	5
42	Udhëheqësi i Divizionit për Burime Njerëzore dhe Administrimin e Dokumenteve	1	15	15
43	Zyrtar i Lartë i Personelit	1	10	10
44	Zyrtar për administrimin e dokumenteve dhe arkivë	1	10	5
Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike				
45	Drejtori i ZRCKFSP	1	40	50
46	Asistenti Ekzekutiv	1	10	15
47	Këshilltar Juridik	1	10	5
48	Ekspert i Bazës së të Dhënave	1	10	5
49	Udhëheqësi i Njësisë për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike	1	15	15
50	Zyrtar i lartë për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike	2	10	5
51	Udhëheqësi i Njësisë për kontrollin financiar të subjekteve politike	1	15	15
52	Ekspert për kontroll financiar	4	10	5

Shënim:

- Realizimi i shërbimeve të telefonisë mobil bëhet përmes mbushjeve elektronike apo pakove postpaid.
- Secili i punësuar njofton ZKF në muajin dhjetor të secilit vit në lidhje me opsionin e shfrytëzimit të pakove të telefonisë mobile sipas kontratës.
- Punonjësve që nuk kanë numër mobil te Vala, pajisen me numër.